



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2793/ 6 prot

Datë 12 .12.2023

V E N D I M
Nr. 1287 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.12.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SARK” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-84894-10-23-2023, me objekt: “*Furnizim vendosje parketi i palestrës së shkollës së mesme “Janaq Kilica” Fier dhe i palestrës së shkollës së mesme “Nasif Zhavarri”, fshati Kafaraj, NJ. ADM. Frakull, Fier*”, me fond limit 5,264,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Ankimues: Operatori ekonomik “SARK” SHPK me Nipt. L52531415H
Adresa: Lagjja “8 Shkurti”, Rr. ”Skënderbeu”, Fier.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fier.
Adresa: Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier.

Subjekt i Interesuar: Operatori ekonomik “V E K O” SHPK me Nipt K12511628P
Adresa: Vresera, Gjirokastër.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.10.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-84894-10-23-2023, me objekt: “Furnizim vendosje parketi i palestrës së shkollës së mesme “Janaq Kilica” Fier dhe i palestrës së shkollës së mesme “Nasif Zhavarri”, fshati Kafaraj, NJ. ADM. Frakull, Fier”, me fond limit 5,264,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Në datë 03.11.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se në datën 06.11.2023, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

SARK SHPK	me ofertë	4.550.000 Lekë pa TVSh	skualifikuar
V E K O SHPK.	“	4.956.000 “	kualifikuar

II.4. Në datën 10.11.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim fituesi paraparak në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “SARK” SHPK me numër 2793/2023 prot., datë 13.11.2023 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-84894-10-23-2023, me objekt: “*Furnizim vendosje parketi i palestrës së shkollës së mesme “Janaq Kilica” Fier dhe i palestrës së shkollës së mesme “Nasif Zhavarri”, fshati Kafaraj, NJ. ADM. Frakull, Fier*”, me fond limit 5,264,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “SARK” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2793/2 prot., datë 14.11.2023 lidhur me pretendimet e ankimuesit “SARK” SHPK, mbi arsyet e skualifikimin të ofertës së tij.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 9310/14 prot., datë 22.11.2023, protokolluar me tonën me nr.2793/3, datë 23.11.2023, autoriteti kontraktor ka paraqitur “*Informacion*” pranë Komisionit të Prokurimit Publik si dhe vendimin me Nr.9310/13, datë 22.11.2023 të KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mos pranim të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “SARK” SHPK.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar “V E K O” SH.P.K nuk ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "SARK" SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së parë të skualifikimit:

"Operatori ekonomik SARK SHPK me NUIS K52531415H

I Për plotësimin e kriterit 2.3 Kapaciteti teknik:2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se 900 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet),që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Për këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:

a-Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose / dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. ose

b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Për përmbushjen e kësaj pike O.E SARK SHPK ka paraqitur një kontratë nr.8844/2 prot, datë 27.10.2022 lidhur me Bashkinë Korçë (ent publik), bashkëngjitur së cilës ishin dokumentet si më poshtë:

- Shtojca 2, Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit*
- Çertifikatë e përkohëshme e marrjes në dorëzim të punimeve*
- Akt kolaudimi.*

KVO konstaton se O.E SARK SHPK nuk ka paraqitur Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, siç kërkohet të paraqesë në pikën 2.3.1/a, ç'ka përbën shkak për skualifikim. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.1.1 Autoriteti kontraktor me Shtojcë 7, FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES / KUALIFIKIMIT, 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se 900 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet),që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëm:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose / dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.2. Nga verifikimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se operatori ekonomik "SARK" SHPK në përmbushje të kriterit 2.3.1./a Mbi furnizimet të mëparshme, si më sipër cituar ka dorëzuar në sistem dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë me Nr. 8844/2 Prot, Datë 27/10/2022 me objekt "Punime mdërtimore në kuader te rehabilitimit të qendres aktuale dhe ngritjes se infrastrukturë": me pale Bashkia Korçë dhe Shoqëria "SARK" SHPK.

2. Shtojca 2. Lista e Çmimeve sipas zërave të preventivit për procedurën e prokurimit me Nr. REF-42990-09-20-2022

3 .Çertifikatë e Përkohshme e Marrjes në Dorëzim të Punimeve lëshuar nga Bashkia Korçë "Punime mdërtimore në kuader te rehabilitimit të qendres aktuale dhe ngritjes se infrastrukturë".

4. Akt-Kolaudimii objektit "Punime mdërtimore në kuader te rehabilitimit të qendres aktuale dhe ngritjes se infrastrukturë".

III.1.3. Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se: "5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve".

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: "3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...".

III.1.4. Në nenin 40, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre

viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në interpretim literal të bazës ligjore të sipërcituar Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimes, mbi modifikimin e kriterit të veçantë sipas pretendimeve më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesat në fjalë shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon se është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor që me kriterin kualifikues për furnizimet e mëparshme, të ngjashme të sigurohet që operatorët ekonomikë janë në gjendje të përmbushin kontratën objekt prokurimi.

Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kushtin Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **900 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) *Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose / dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon mbi dokumentacionin e procedurë së prokurimit dhe dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “SARK” SHPK në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), nga ku rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentent cituar e listuar në pikë III.1.2 të këtij vendimi, por referuar kriterit kualifikues nuk ka paraqitur *Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara*, kërkesa këto në përmbushje të kriterit 2.3.1.

Komisioni gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor, që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “SARK” SHPK, nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit në lidhje: Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose / dhe fatura tatimore të shitjes.

Përsa referuar më sipër pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “SARK” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së dytë të skualifikimit:

II. Për plotësimin e kriterit 2.3 Kapaciteti teknik:2.3.5 Shoqëria duhet të jetë e pajisur edhe me certifikatën e mëposhtme:

a) Çertifikatë e vlefshme, për objektin që prokurohet, ISO 9001:2015 ose ekuivalente e saj, për “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, (e cila nëse është në gjuhë të huaj, duhet të jetë e përkthyer në shqip dhe e noterizuar), e lëshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Ndërkombëtare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.

O.E SARK SHPK ka paraqitur në SPE për plotësimin e këtij kriteri Çertifikatën ISO (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) si më poshtë: Çertifikata e cilësisë ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) e SARK SHPK NIPT K52531415H, Rruga Skënderbej, Lagjja 8 Shkurti, Rajoni nr.3, përballë supermarket Lalaj, Fier, Albania me nr. certifikate AQS/Q/111262023, për fushën e aktiviteteve si më poshtë:

“Projektimi, ndertimi i objekteve civile, industriale dhe infrastrukture (rruge dhe infrastrukture rrugore, ujesjellesa, kanalizime, ...etj,Projektimi, ndertimi dhe mirembajtja e veprave elektrike per shperndarjen dhe transmetimin e energjise elektrike te tensionit te ulet, te mesem dhe te larte. Krijimi dhe mirembajtja e hapësirave te gjelberta, publike dhe private. Prodhimi, tregtim dhe montimi i portave dhe dritareve ne PVC”

Në rastin e certifikatës ISO të paraqitur nga O.E SARK SHPK fusha e veprimtarisë e kësaj certifikate nuk përputhet me objektin që prokurohet, ç’ka përbën shkak për skualifikim.

III.2.1 Autoriteti kontraktor me Shtojcë 7, FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES / KUALIFIKIMIT, 2.3 Kapaciteti teknik

2.3.5 Shoqëria duhet të jetë e pajisur edhe me certifikatën e mëposhtme:

a) Çertifikatë e vlefshme, për objektin që prokurohet, **ISO 9001:2015** ose ekuivalente e saj, për “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, (e cila nëse është në gjuhë të huaj, duhet të jetë e përkthyer në shqipë dhe e noterizuar), e lëshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Ndërkombëtare Akreditues të njohura në Republikën e Shqipërisë.

III.2.2. Nga verifikimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se operatori ekonomik “SARK” SHPK në përmbushje të kriterit 2.3.5./a Çertifikatë e vlefshme, për objektin që prokurohet, **ISO 9001:2015** ose ekuivalente e saj, si më sipër cituar, ka dorëzuar në sistem dokumentacionin si më poshtë:

Lëshuar nga

AQSCERT

Certifikatë Konformiteti Për Sistemin e Manaxhimit të Cilësisë.

Nr. i Certifikatës:

AQS/Q/111262023

Emri i Kompanisë: SARK SHPK NIPT K52531415H,

Adresa: Rruga Skënderbej, Lagjja 8 Shkurti, Rajoni nr.3, Përballë supermarket Lalaj, Fier, Albania.

Standardi: EN- ISO 9001:2015

Për fushat e Aktivitetit si më poshtë:

Projektimi, ndertimi i objekteve civile, industriale dhe infrastrukture (rruge dhe infrastrukture rrugore, ujesjellesa, kanalizime, ...etj) Projektimi, ndertimi dhe mirembajtja e veprave elektrike per shperndarjen dhe transmetimin e energjise elektrike te tensionit te ulet, te mesem dhe te larte. Krijimi dhe mirembajtja e hapesirave te gjelberta, publike dhe private. Prodhimi, tregtim dhe montimi i portave dhe dritareve ne PVC

III.2.3 Në nenin Neni 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efiçencës së energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.2.4. Në nenin Neni 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, , parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.5. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë

pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë.

Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt-prokurimi sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatës së mësipërme dhe në përmbushje të kritereve të veçanta të kualifikimit, shoqëria “SARK” SHPK ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015, për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, në fushat e mëposhtme të aplikimit: *“Projektimi, ndertimi i objekteve civile, industriale dhe infrastrukture (rruge dhe infrastrukture rrugore, ujesjellësa, kanalizime, ...etj) Projektimi, ndertimi dhe mirembajtja e veprave elektrike për shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë. Krijimi dhe mirembajtja e hapësirave të gjelbërta, publike dhe private. Prodhimi, tregtimi dhe montimi i portave dhe dritareve në PVC”*, lëshuar nga AQSCERT datë ricertifikimit 25.06.2023 dhe datë skadence 24.06.2024, lëshuar në emër të subjektit “SARK” SHPK. me disa fusha aktiviteti ndër to **“Projektimi, ndertimi i objekteve civile,....”** e cila rezulton e njëjtë me objektin e prokurimit *“Furnizim vendosje parketi i palestrës së shkollës së mesme “Janaq Kilica” Fier dhe i palestrës së shkollës së mesme “Nasif Zhavarri”, fshati Kafaraj, NJ. ADM. Frakull, Fier”*, Pra kjo certifikatë rezulton në përputhje me objektin e prokurimit.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “SARK” SHPK., me dokumentacionin e paraqitur, e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7, pika 2.3.5/a, “Kapaciteti teknik”, në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi vërtetohet se është i certifikuar sipas standardit ISO 9001-2015 për shërbimin objekt-prokurimi e vlefshme dhe e lëshuar nga Organizmat e Vlerësimit të Konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA).

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “SARK” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së tretë të kualifikimit:

III. Për plotësimin e kriterit 2.3 Kapaciteti teknik:2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

a) Autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, për materialet (binarë druri, parket druri,astar,membranë për pengesë të lagështirës).

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit.

Secili nga dokumentat e sipërcituar, duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, si: tel., e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, si dhe të jetë origjinale ose fotokopje e noterizuar e njehsuar me origjinalin, dhe nëse është në gjuhë të huaj, duhet të jetë e përkthyer në shqip dhe e noterizuar, sipas konfirmimit të noterit.

b) Për materialet e kërkuara (binarë druri, parket druri,astar,membranë për pengesë të lagështires), të paraqiten katalogë/t ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen, si dhe të paraqiten certifikatë / deklaratë konfirmimit CE ose certifikatat e cilësisë ose raportet e testimi nga laboratore të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në specifikimet teknike për këto materiale.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe të cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Për përmbushjen e pikës 2.3.6/a O.E SARK SHPK ka paraqitur një dokument me emërtim “Autorizim_Prodhuesi_Parket_1” me VROHORITI SHPK me NUIS L14618002G, I cili shprehet se si distributor kryesor dhe përfaqësues ekskluziv, autorizon OE SARK SHPK të tregtojë mallërat e ofruar nga ana e subjektit VROHORIT SHPK. KVO konstaton se O.E SARK SHPK nuk ka paraqitur document për të provuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit.

Për përmbushjen e pikës 2.3.6/b O.E SARK SHPK ka paraqitur document me emërtimin “Katalog_skeda_teknike_certifikata_parket.pdf” I cili përmban dokumentacion në gjuhë të huaj, të papërkthyer në shqip si dhe të panoterizuara. Dokumentacion I paraqitur nuk është në përmbushje të kërkesave ligjore për plotësimin e kriterit 2.KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT pika 2.3.6 të DST-së, ç’ka përbën shkak për skualifikim.

III. 3.1 Autoriteti kontraktor me Shtojcë 7, FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES / KUALIFIKIMIT, 2.3 Kapaciteti teknik ka kërkuar në pikën :

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

a) Autorizim prodhuesi **ose** autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, për materialet (**binarë druri, parket druri,astar,membranë për pengesë të lagështirës**).

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit.

Secili nga dokumentat e sipërcituar, duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, si: tel., e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, si dhe të jetë origjinale ose fotokopje e noterizuar e njehsuar me origjinalin, dhe nëse është në gjuhë të huaj, duhet të jetë e përkthyer në shqip dhe e noterizuar, sipas konfirmimit të noterit.

b) Për materialet e kërkuara (**binarë druri, parket druri,astar,membranë për pengesë të lagështires**), të paraqiten katalog/ët **ose** skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen, si dhe të paraqiten certifikatë / deklaratë konfirmimit CE **ose** certifikatat e cilësisë **ose** raportet e testimi nga laboratore të

akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në specifikimet teknike për këto materiale.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu,

III.3.2. Nga verifikimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, konstatohet se operatori ekonomik “SARK” SHPK në përmbushje të kriterit 2.3.6/a ka paraqitur dokumentin:

1. Autorizim i Prodhuesit lëshuar nga Administratori i Shoqërisë “VROHORITI” ShPK si distributor kryesor dhe përfaqësues eskuziv në Shqipëri për tregëtim dhe shitje me shumicë dhe pakicë të lëndëve drusore të sharruara, të presuara si binarë druri, parket druri, parket laminat, membrana për pengesë lagështirës, astar, kolona druri, katrama, letër katrama, tjegulla qeramike dhe betoni etj.

III.3.3. Në nenin 24 pika 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se:

1. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, nga pjesëmarrësit bazuar në dokumentet standarde të tenderit.

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 15 pika 2 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se: “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit

2. Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:

- *njoftimin paraprak të informacionit/ njoftimin periodik të informacionit*
- *njoftimin e kontratës;*
- *ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me fazë);*
- *udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;*
- *kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes*

Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.3.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të

paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me plotësimin e kriterit më sipër ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin: *“Autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, për materialet (binarë druri, parket druri, astar, membranë për pengesë të lagështirës)...*

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Cituar më sipër kriteri i plotë, Sa më lart, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “SARK” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin : *1. Autorizim i Prodhuesit lëshuar nga Administratori i Shoqërisë “VROHORITI” ShPK si distributor kryesor dhe përfaqësues ekskluziv në Shqipëri për tregëtim dhe shitje me shumicë dhe pakicë të lëndëve drusore të sharruara, të presuara si binarë druri, parket druri, parket laminat, membrana për pengesë lagështirës, astar, kolona druri, katrama, letër katrama, tjegulla qeramike dhe betoni*”. Komisioni referuar dokumentacionit paraqitur nga operatori ekonomik “SARK” SHPK. konstaton se OE nuk ka plotësuar kriterin e mësipërm të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, pasi nga verifikimi i përmbajtjes së dokumentit “*Autorizim prodhuesi*” të ngarkuar nga operatori ekonomik ankimues në sistem, rezulton se Firma VROHORITI SHPK që sipas dokumentit lëshuar nga administratori është distributor dhe përfaqësues ekskluziv në Shqipëri. Por referuar kriterit ku kërkohet **Autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi**, autorizimi i lëshuar nga Firma VROHORITI SHPK nuk ka dokument provues që të tergojë lidhjen midis **distributorit të autorizuar nga prodhuesi**, kërkuar në kriter.

Në këtë kuadër Komisioni gjykon se me dokumentacionin e paraqitur operatori ekonomik ankimes “SARK” SHPK nuk përmbush kriterin më sipër **pika 2.3.6/a**.

III.3.6. Në lidhje arsyen e skualifikimit, në përmbushje të kriterit 2.3.6/b operatori ekonomik “SARK” SHPK ka paraqitur dokumentin:

Katalog_skeda _teknike _certifikata _parketi

III.3.7. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën 7, 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

b)Për materialet e kërkuara (**binarë druri, parket druri,astar,membranë për pengesë të lagështires**), të paraqiten katalog/ët **ose** skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen, si dhe të paraqiten çertifikatë / deklaratë konfirmimit CE **ose** çertifikatat e cilësisë **ose** raportet e testimi nga laboratore të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në specifikimet teknike për këto materiale.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe të cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

III.3.8 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.3.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me plotësimin e kriterit për kualifikim ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin: 2.3.6/b)Për materialet e kërkuara (**binarë druri, parket druri,astar,membranë për pengesë të lagështires**), të paraqiten katalog/ët **ose** skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen, si dhe të paraqiten çertifikatë / deklaratë konfirmimit CE **ose** çertifikatat e cilësisë **ose** raportet e testimi nga laboratore të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në specifikimet teknike për këto materiale.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe të cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Autoriteti kontraktor ka publikuar në Seksionin 1, Njoftimi i Kontratës, Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.

4.5 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip

X

Anglisht

Gjithashtu Në shtojcën nr. 7, “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Komisioni i Prokurimit Publik referuar dokumentacionit të procedurës së prokurimit, shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “SARK” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, konstaton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin: *emërtuar Katalog_skeda _teknike_certifikata_parketi*, i cili përmban 20 fletë , certifikata nga prodhues të ndryshëm në shteteve të ndryshme që rezultojnë të jenë në disa gjuhë të huaja dhe të pashoqëruara me përkthim, duke bërë të pamundur të kuptohet informacioni që ato përmbajnë. Komisioni referuar DST sqaron se, përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës, që paraqitet në këtë procedurë prokurimi.

III.3.10. Në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe nuk duhet të ndryshohen për asnjë arsye nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar qartësisht se “*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe*” në këtë kuadër i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit në sistem elektronik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Gjithashtu, duke u referuar në DST e procedurës objekt-ankimi, konkretisht në kreun “*Udhëzime për operatorët ekonomikë*” Seksioni 1, “*B Përgatitja e ofertave*” pika 2 “*Gjuha e ofertës*” ku përcaktohet se: *Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim*”, duhet që të gjithë dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të jenë në gjuhën shqipe siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në pikën 1.4 të njoftimit të kontratës ose nëse janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastin konkret në sistemin e prokurimit elektronik operatori ekonomik ankimes “SARK” SHPK ka paraqitur, në gjuhë të huaj, dokumentin emërtuar *Katalog_skeda _teknike_certifikata_parketi*, të pashoqëruar me përkthim në gjuhën shqipe, në kundërshtim me atë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në përmbajtjen e dokumenteve të

tenderit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të dosjes gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, duke dorëzuar dokumente në gjuhë të huaj të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, një kusht ky i detyrueshëm për ankimuesin, pasi ai duhet të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, si dhe të paraqesë çdo dokumentacion, që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit.

Komisioni I Prokurimit Publik në analizë të dokumentacionit të dosjes administrative gjykon, se me dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "SARK" SHPK nuk përmbush kriterin më sipër 2.3.6/b.

Përsa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "SARK" SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së katërt të skualifikimit:

IV. Për plotësimin e kriterit 2.3 Kapaciteti teknik: 2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion, të cilat janë si më poshtë:

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion, mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe personelit (pronësiosë me qera), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8):

- Kokore, minimumi 5 copë.

- Fikese zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secili, minimumi 2 copë.

- Komplete të ndihmës së shpejtë, minimumi 2 copë.

Për përmbushjen e pikës 2.3.7/b, O.E SARK SHPK në deklaratën e paraqitur sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8., nuk ka deklaruar asnjë nga mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe personelit, siç kërkohen në pikën 2.3.7/b, ç'ka përbën shkak për skualifikim. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim."

III.4.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën 7, 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion, të cilat janë si më poshtë:

a) Mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8):

Nr.	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamionçinë (për transport materiale dhe makineri)	në pronësi ose me qera	copë	1
2	Sharrë (për prerje eventuale të materialit të drurit)	në pronësi ose me qera	copë	1
3	Zmerilatriçe (për zmerilim të sipërfaqes së parketit)	në pronësi ose me qera	copë	1

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion, mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe personelit (pronësiosë me qera), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8):

- Kokore, minimumi 5 copë.
- Fikese zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secili, minimumi 2 copë.
- Komplete të ndihmës së shpejtë, minimumi 2 copë.

Shënim: Për pikën 2.3.7 (a dhe b) si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.3.7 (a dhe b), duke dorëzuar dokumentacionin original ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) Paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe / ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) Është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe / ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para dates dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve si parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt o indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energji elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, si përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, në përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit i

Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nejjshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*_____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar	Po [] Jo []

nga Autoriteti kontraktor.	

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p><u>Punonjës</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/> <p>Profili i punonjësve</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p>Emri, Mbiemri _____</p> <p>Firma _____</p> <p>Vula _____</p> <p>Data e dorëzimit të deklaratës _____</p>	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për

përrjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.4.2 Nga verifikimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimit Elektronik , konstatohet se operatori ekonomik “SARK” SHPK ka dorëzuar të plotësuar: dokumentin emertuar

Formulari_i_Vetdeklarimit SARK

III.4.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.4.4. Vendosja e kriterëve të kualifikimit, ka si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në

procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kritereve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. “*të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale*”, si edhe nga neni 3 i Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” “*Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.*”

III.4.5 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës, autoriteti kontraktor ka kërkuar në pikën:

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion, të cilat janë si më poshtë:

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion, mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe personelit (pronësiosë me qera), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (*sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8*):

- Kokore, minimumi 5 copë.
- Fikese zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secili, minimumi 2 copë.
- Komplete të ndihmës së shpejtë, minimumi 2 copë.

Shënim: *Për pikën 2.3.7 (a dhe b) si më sipër, operatorët ekonomikofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.*

E cila do të quhet e përmbushur me plotësimin e Formularit të Vetëdeklarimit.

Referuar dokumentacionit të ofertës të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, se operatori ekonomik ankimues në përmbushjen e këtij kriteri ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe nga verifikimet e kryera u konstatua se: Formulari i paraqitur, nga operatori ekonomik “SARK” SHPK, në pjesën III, Krite të Përzgjedhjes/Kualifikimit, B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), operatori ekonomik ankimues ka plotësuar :

Disponim të personelit, Po X ,

Nëse po nr. I punonjësve 11 si edhe ka listuar personelin.

Disponim makineri e mjete Po X , Nëse po të Listohen,

OE nuk ka listuar disponim të makineri dhe mjete për të cilat ka pohur se i disponon.

Komisioni vëren se, ligjvënësi me qëllim që të lehtësojë operatorëve ekonomikë në përgatitjen e ofertave, ka vënë në dispozicion Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit për të evituar një sërë dokumente provues që do të duheshin për të përmbushur kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit vendosura nga AK. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të përmbushin kriteret për kualifikim me përgatitjen e dokumentacionit të ofertave dhe mosplotësimi i tyre përbën shkak për skualifikim. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, në procedurën e prokurimit e konkretisht Shtojca 8, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i pa rregullt pasi nuk përmban të gjithë informacion e kërkuar nga AK në përmbushje të kriterëve kualifikuese.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “SARK” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me REF-84894-10-23-2023, me objekt: “*Furnizim vendosje parketi i palestrës së shkollës së mesme “Janaq Kilica” Fier dhe i palestrës së shkollës së mesme “Nasif Zhavarri”, fshati Kafaraj, NJ. ADM. Frakull, Fier*”, me fond limit 5,264,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit në lidhje me vlerësimin e operatorit ekonomik ankimes sipas konstatimeve të këtij vendimi.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ”SARK” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri